

K u j t e s e

I n d e r u a r K l i e n t !

Ligji 31/2019 date 17.06.2019, i cili eshte ne ndryshim te ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSh” dhe qe ka hyre ne fuqi me daten 25.07.2019, ne menyre te permbledhur thekson Detyrimin ligjor qe:

të kenë llogari bankare dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

1.Subjektet per deklarim

Tatimpaguesit për Tvsh-ne, Persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi dhe OJF-te,

2.Detyrimi per deklarim eshte:

Per subjektet egzistuese 90 dite nga hyrja ne fuqi qe i takon data 26.10.2019

Per subjektet e reja 20 dite nga e nesermja e regjistrimit ne QKB

3.Sanksionet per mos deklarimin:

Biznesi i vogel 25.000 leke dhe per heren e dyte dy fishi 50.000 leke

OJF-te 37.000 leke dhe per heren e dyte dy fishi 74.000 leke

Bizneset e tjera 50.000 leke dhe per heren e dyte dy fishi 100.000 leke

Terheq vemendjen qe:

Cdo ndryshim ne llogarite bankare (Mbyllje te llogarive egzistuese apo hapje llogarish te reja) i pa deklaruar konsiderohet mos deklarim dhe i nenshtrohet sanksioneve perkatese.

Me poshte
ligjin komplet dhe nje model te mundeshem per deklarimin e llogarive bankare.

Ligji 31/2019 date 17.06.2019

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 59, pas pikës 1/1 shtohen pikat 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

"1/2. Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës së regjistruar dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

1/3. Tatimpaguesit e regjistruar rishtas, janë të detyruar të hapin llogarinë bankare të biznesit/organizatës jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga e nesërmja e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore."

Neni 2

Në nenin 120 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 1/2 dhe 1/3 të nenit 59, të këtij ligji nga tatimpaguesit dënohen si më poshtë:

a) për tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8.000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 25.000 lekë;

b) për tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8.000.000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 50.000 lekë;

c) për organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 37.000 lekë.

Në rast të vazhimit të mosrespektimit të detyrimit të pikës 1/2 dhe 1/3, të nenit 59, të këtij ligji, edhe pas dënimit, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të këtij paragrafi, tatimpaguesi dënohet me dyfishin e gjobës së parë."

Neni 3 Dispozitë kalimtare

Tatimpaguesit e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/administratës tatimore janë të detyruar të hapin llogarinë bankare, jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 17.6.2019

Shpallur me dekretin 11213, datë 4.7.2019 të Presidentit të RSh, Ilir Meta.

Botuar ne F.Zyrtare 99/2019
Dale nga shtypi 10.07.2019

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Shoqeria “ _____ ” Shpk.

NIPT-i : _____

Adresa : _____ me _____

Drejtorese Rajonale Tatimore

Ne zbatim te Ligji 31/2019 date 17.06.2019, ne ndryshim te ligjit 9920 date 19.05.2008
“Per Procedurat Tatimore ne RSh” neni 1 qe ndryshon te nenit 59:

1. Deklarojme llogarite bankare me te cilat ne operojme aktualisht:

Nr	Emri i Bankes	Monedha	Nr llogarise
1	BKT	Leke	
2	BKT	Euro	
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			

2. Per çdo ndryshim, po ne zbatim te ligjit, do t'ju bejme me dije.

Duke Ju falenderuar per mirekuptimin

Administrator